

**VENDIM**  
**Nr. 401, datë 4.7.2018**

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN**  
**NR. 718, DATË 29.10.2004, TË KËSHILLIT**  
**TË MINISTRAVE, “PËR LISTËN**  
**E PERSONAVE TË SHPALLUR**  
**SI FINANCUES TË TERRORIZMIT”,**  
**TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 14, pika 1, 18, pika 1, 25, pika 1, dhe 28, pika 1, të ligjit nr. 157/2013, datë 10.10.2013, “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Në listën e personave të shpallur sipas rezolutave të Këshillit të Sigurimit (“Lista e OKB-së”), që i bashkëlidhet vendimit nr. 718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhet shtesa si më poshtë vijon:

Në listën e shkronjës “C”, të titulluar “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatat ISIL (Da’esh) dhe AL-Qaida”, shtohen individët e renditur në shkronjën “a”, sipas shtesës bashkëlidhur këtij vendimi, në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, për persona që janë anëtarë, bashkëpunëtorë apo financues të organizatave ISIL (Da’esh) dhe AL-Qaida”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Edi Rama**

**PËRDITËSIMI NË LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË**  
**TERRORIZMIT SIPAS REZOLUTAVE TË KËSHILLIT TË SIGURIMIT TË OKB-së**  
**(“LISTA E OKB-së”)**

**C. LISTA E INDIVIDËVE ANËTARË OSE BASHKËPUNËTORË ME ORGANIZATAT**  
**ISIL (DA’ESH) DHE AL-QAIDA”:**

a) Lista e shtuar në “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatat ISIL (Da’esh) dhe AL-Qaida”:

1. MYRNA; AJIJUL; MABANZA;
2. ABDULPATTA; ESCALON; ABUBAKAR.

Shënim. Gjenealogjet e tjera për personat dhe kompanitë, emrat e të cilëve janë radhitur më sipër, mbahen në Drejtorinë e Përgjithshme të Paranda-limit të Pastrimit të Parave.